



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN




Drejtoria Për Bujqësi, Pylltari
Dhe Zhvillim Rural

08 Nr. _____/2021 Dt. _____/_____/2021

Në bazë të vendimit **01.NR.XI-6** të dt: **30.11.2020**, miratuar nga Kuvendi Komunal në Deçan, në bazë të nxjerrjes së aktit të ligjshmërisë nga MBPZHR me nr të **Prot: 5079/2** të dt: **23.12.2020** si dhe pëlqimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nr të **Prot:4232/3** të dt: **09.11.2020**, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural shpall:

OFERTË PUBLIKE



Për dhënien në menaxhim me qira të Vend –gjuetisë së Përbashkët “ Lojzat” që shtrihet në territorin e komunës së Deçanit.

Bazuar në Nenet 34, 35 dhe 36 të Ligjit për Gjueti nr.02/L -53, Udhëzimit Administrativ nr.06/2009 për Dhënie në Menaxhim të Vend gjuetisë së Përbashkët, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural shpall Ofertën Publike për dhënien në menaxhim me qira të Vend gjuetisë së Përbashkët “ Lojzat”.

1. Te dhënat e vend-gjuetisë së përbashkët që shtrihet në territorin e Komunës së Deçanit

Sipërfaqja e përgjithshme e vend gjuetisë që shtrihet në territorin e Komunës së Deçanit është 11.654.00 prej se cilës, sipërfaqja e lejuar për gjueti është 8.157.80 ha, ndërsa sipërfaqja në të cilën është e ndaluar gjuetia është 3.496.20 ha.

Me dokumentin nr.37/2 date 23.04.2012 lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është dhënë pëlqimi për themelimin e vend- gjuetisë së përbashkët “ Lojzat”.

1.1 Karakteristikat themelore të vend-gjuetisë së përbashkët “ Lojzat”

Vend-gjuetia e përbashkët “ Lojzat” i përket tipit të gjuetisë kodrinore –malore dhe një pjese e tipit të ultë (Toka bujqësore, livadhe dhe kullota të ultë). Llojet kryesore të egërsirave që gjenden në vend - gjueti janë: dhelpira 125; derri i egër 125; lepuri 460; macja e eger 34; ujku 85; ketri 137; lundërza 24; vjedulla 92. Llojet e shpendëve kryesore janë: Thëllëza fushore 370; pëllumbi i egër 930; pata e eger 127, gjeraqina 55, skifteri 72 copë.

1.2 Strukturat e sipërfaqës së vend-gjuetisë së përbashkët “ Lojzat”

1. Sipërfaqja e përgjithshme e vend-gjuetisë “Lojzat” është 11.654,00 ha
2. Sipërfaqja aktive (roductive) e vend- gjuetisë = 8.157,80 ha
3. Sipërfaqja ku është e ndaluar gjuetia = 3.469,20 ha

2. Përmbajtja e ofertës

Materiali ofertues përveç tjerash duhet te përmbaj:

- Përshkrimin për rëndësinë e vend-gjuetisë së përbashkët, qëllimi i saj dhe vizioni i menaxhimit në të ardhmen;
- Emërtimi i vend-gjuetisë;
- Harta, sipërfaqja dhe përshkrimi i kufijve të vend-gjuetisë;(Hartat mund te tërhiqen ne zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë);
- Llojet dhe numri i kafshëve të egra në vend gjueti;
- Sipërfaqja e përgjithshme dhe strukturat e sipërfaqës: pyje, toka pyjore, livadhe, kullosa, ara, kopshte etj;
- Infrastruktura ekzistuese (objektet) teknike dhe përcjellëse në vend-gjueti dhe
- Çmimi fillestar i qerasë për vend-gjueti.

3. Kushtet e Ofertës Publike

Kushtet e dhënies se vend-gjuetisë së përbashkët në menaxhim me qiranë janë rregulluar me Ligjin Nr.02/L-53 për Gjuetinë, Neni 34, paragrafët 34.1;34.2;34.4;34.5; dhe 34.6 si dhe aktin nënligjor – Udhëzimi Administrativ Nr.06/2009, Neni 5.

Kushtet e përcaktuara për dhënien në menaxhim me qira të vend-gjuetisë të përbashkëta janë:

- 1.Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;
- 2.Dëshmia mbi përvojën e punës së menaxhimit me kafshë të egra (kjo vlen për menaxherët e gjertanishëm të vend-gjuetive dhe kafshëve të egra –shoqatat anëtare të Federatës së Gjahtarëve të Kosovës (FGJK), si dhe përshkrimin i rezultateve menaxhuese nga viti paraprak;
- 3.Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme – për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm dhe ekologji;
- 4.Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve – gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës;
- 5.Programin për synimin e menaxhimit dhe zhvillimit të vend-gjuetive –mbrojtja dhe ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
- 6.Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për veprë penale;
- 7.Dëshmi që vërtetohet se subjekti ofertues nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
- 8.Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
9. Çmimi më i lartë i ofertës për qiranë.

4. Kushtet shtesë për përzgjedhjen e subjekteve ofertuese për marrje me qira në menaxhim të vend-gjuetisë

Meqenëse qëllimi kryesor i dhënies në menaxhim të vendgjuetive është mbrojtja, kultivimi dhe shtimi i numrit të llojeve të faunës së egër dhe përmirësimi i kushteve të jetesës dhe zhvillimit të tyre, çmimi i dhënies me qira nuk mund të jetë përcaktues kryesor i përzgjedhjes së subjektit përfitues (menaxherit të vendgjuetisë), posaçërisht në rastin e Kosovës, përfshirë edhe vend-gjuetinë që shtrihen në territorin e Deçanit.

Përcaktues të përzgjedhjes së ofertuesëve (menaxherëve të vend-gjuetisë), përveç kriterëve të përcaktuara me akte ligjore, sugjerohet të jenë edhe këto kriterë:

- Strukturat kualifikuese e anëtarëve të shoqatave të cilat konkurrojnë, përvoja dhe trajnimi i tyre;
- Infrastruktura ekzistuese dhe investimet në infrastrukturë në përvojën e mëparshme të menaxhimit të vend-gjuetisë si: Shtigjet e kafshëve të egra, rezervarët për uji të pijshëm, pyjore, përvoja në kultivimin e tyre etj;
- Ofrimi i dëshmive për mundësi investuese të mbrojtjes, kultivimit dhe importin e llojeve të caktuara të kafshëve dhe shpendëve të egra.

5. KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Subjekti ofertues i cili plotëson kushtet e lartshënuara dhe vlerësohet me më shumti pikë do të shpallet fitues i projektit.

Afati për tërheqje të materialit ofertues sipas Udhëzimit Administrativ NR. 06/2009 është prej datës 22.09.2021 deri më datë 29.09.2021 në ora 13:00.

Materiali ofertues tërhiqet në Zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr 34 Kati i tretë dhe dorëzohet në Zyrën e Prokurimit Nr 33 në katin e dytë Komuna e Deçanit.

Afati për dorëzimin e ofertave: Tetë ditë.

Hapja e ofertave bëhet me datë 29.09. 2021 në ora 13:30 në sallën e Konferencave në katin e tretë në objektin e Komunës së Deçanit.

APLIAKSIONI I SHPALLJES PUBLIKE

Datë: 22/09/2021

Numri referues i shitjes:

EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar : Komuna e Deçanit , Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		
Adresa: Rr Jashar SALIHU/ Nr 3		
Qyteti : Deçan	Kodi postar	Telefoni
Kontakti : Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë Dhe Zhvillimit Rural – Rifat Stojkaj	51000	044302900
Email: rifat.stojkaj@rks-gov.net	Faksi 039/361 030	
Adresa e faqes se internetit: https://kk.rks-gov.net/decan/		

LËNDA E OFERTËS PUBLIKE :

1. Dhënia ne menaxhim e Vend- Gjuetisë së Përbashkët “ **Lojzat**” ne sipërfaqe të përgjithshme prej 11.654,00ha
2. Sipërfaqe aktive (produktive) e vend-gjuetisë =8.157.80ha
3. Sipërfaqe ku është e ndaluar gjuetia =3.496,20ha

Objekti i Ofertës Publike është Vend-gjuetia që shtrihen ne territorin e Komunës se Deçanit e cila është themeluar me Vendimin e Kuvendit te Komunës me numër : 01 .NR.XI-6

Specifikimi (pasqyra) e te dhënave dhe llogaritjeve për zhvillimin e procedurës se Ofertës Publike është paraqitur ne tabelat ne vijim . Llogaritjet janë bere sipas numrit te egërsirave regjistruar nga Komisioni i caktuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Vendimin 01.NR.XI-6

VEND -GJUETIA “ LOJZAT”										
TE DHENAT BAZË PËR PËRGADITJEN E OFERTËS PUBLIKE TË DHËNIES ME QIRA TE VENDGJUESISË										
Lloji	Gjinia	Fondi sipas te dhënave te MBPZHR – DP (FA)	Kapaciteti prodhues i vendgjuetise	Shtimi/krerë sipas Fondit Ame	Humbjet (dëmtimet) e mundshme 30%	Fondi për gjueti	Numri i lejuar për gjueti	Çmimi cope/krerë/€	Gjithsej €	Çmimi baze për shpallje publike sipas Ligjit, neni 35, paragrafi 35.2
Dhelpra	Femra	62	44	62	37	87	1		100	
	Meshkuj	63	44	63	38	88	1		100	
Gjithsejte	F+M	125	88	125	75	175	2	100	200	100
Derri i egër	Femra	62	32	62	37	87	1		80	
	Meshkuj	63	31	63	38	88	1		80	
Gjithsejte	F+M	125	63	125	75	175	2	80	160	80
Lepuri	Femra	230	115	230	138	322	6		150	
	Meshkuj	230	115	230	138	322	6		150	
Gjithsejte	F+M	460	230	460	276	644	12	25	300	150
Thëllëza e Fushës	Femra	185	92	185	111	259	6		90	
	Meshkuj	185	93	185	111	259	6		90	
Gjithsejte	F+M	370	185	370	222	518	12	15	180	90
Pëllumb i Egër	Femra	465	232	465	279	651	10		100	
	Meshkuj	465	233	465	279	651	10		100	
Gjithsejte	F+M	930	465	930	558	1,302	20	10	200	100
Patat te egra	Femra	63	32	63	38	89	4		60	
	Meshkuj	64	32	64	38	89	4		60	
Gjithsejte	F+M	127	64	127	76	178	8	15	120	60
GJITHSEJ									1,160	
GJITHSEJ ÇMIMI FILLESTAR VJETOR PER I OFERTES PUBLIKE										580

LLOJET E KAFHSEVE TE EGRA TE RRALLA DHE TE MBROJTURA ME LIGJ

MACJA EGER	Femër	17	NE TERRITORIN E VENDGJUE TISE "LOJZA" QE SHTRIHET NE KOMUNEN E DECANIT, JANE EVIDENTUAR DISA KAFSHE DHE SHPEZE TE CILAT JANE TE MBROJTURA ME LIGJ DHE NUK LEJOHET GJUALTJE E TYRE.
	Meshkuj	17	
	F + M	34	
UJKU	Femër	43	
	Meshkuj	42	
	F + M	85	
KETRI	Femër	68	
	Meshkuj	69	
	F + M	137	
GJERAQINA	Femër	27	
	Meshkuj	28	
	F + M	55	
SKIFTERI	Femër	36	
	Meshkuj	36	
	F + M	72	
LUNDERZA	Femër	12	
	Meshkuj	12	
	F + M	24	
VJEDULLA	Femër	46	
	Meshkuj	46	
	F + M	92	

INORMATA SHITESË

Dhënia me qira ne menaxhim te vend gjuetisë së përbashkëta do te jepet ne afate kohore prej 10 vjetësh .

Këshilla juridike : Çdo pale e pakënaqur me procesin e vlerësimit final të ofertave nga Komisioni, ka te drejte te paraqesë ankesë brenda pesë ditësh nga dita e marrjes se rezultateve të vlerësimit.

TË DHËNAT E APLIKUESIT PËR MARRJE NË MEAXHIM ME QIRA TË VENDGJUTISË /VE

Emri zyrtar i subjektit:		
Numri i regjistrimit :		
Numri fiskal:		
Adresa:		
Vendi:	Kodi postar	Komuna
		Telefoni:
		Mob:
		E-mail:

Ofertat dorëzohen ne zarf A4 të vulosura me adresën e subjektit juridik.

Vlerësimi i ofertave : Vlerësimi bëhet nga Komisioni vlerësues . Ofertuesi do te informohen me kohë ne bazë te afateve ligjore të përcaktuara me akte ligjore ne fuqi.

INFORMATA SHITESË PËR APLIKUESIT

Çmimi fillestar i qirasë është 580 E

Çmimi fillestar prej 580 E është i bazuar ne Udhëzimin Administrativ 06/2009 për dhënie ne Menaxhim të Vend- gjuetisë së Përbashkët “ **Lojzat**” sipas te cilit Udhëzim çmimi fillestar i qiradhënie përcaktohet ne vlerën 50% te kafshëve të egra të planifikuara për gjuajtje . Llogaritjet e numrit për lloje të kafshëve të egra janë bere sipas standardeve profesionale .

ÇMIMI I QIRASË OFRUAR NGA APLIKUESI _____EURO

U dorëzohet :

- Drejtorit te Drejtorisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Zyrës Prokurimit

Në dosje.

MENAXHIMI I VENDGJUETISE SE PERBASHKET"LOJZA" NE DEÇAN

Te mbështetur ne Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53, neni 19, Themelimi i vend-gjueti vete përbashkëta, Udhëzimi Administrativ Nr.10/2007 për "Kriteret e Caktimit te Zonave dhe Procedurat për Themelimin e Vend-gjuetive, udhëzimit Administrativ Nr.06/2009 Per dhënie ne menaxhim te vend-gjuetive te përbashkëta, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës se Deçanit ne bashkëpunim me zyrtaret e përgjegjës te komunës, ka përgatitur te gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen e ofertës publike për dhënie ne menaxhim te e vend-gjuetise se përbashkëta e emërtuar "Lojza" me sipërfaqe te përgjithshme prej 11.65400, ha dhe me sipërfaqe ku munde te kryhen aktivitete gjuetie me sipërfaqe prej 8.157,80 ha ne komunën e Deçanit, themeluar dhe aprovuar nga ministri i MBPZHR me datën 09.11.2020, Nr.4232/3.

Objektivat kryesor e menaxhimit e vend-gjuetise se përbashkët

Objektiv kryesore e menaxhimit është respektimi i tërësie se ekosistemit, mbrojtja adekuate e kafshëve te egra autoktone, sigurimi i mirëqenës se tyre dhe te sigurohen kushtet për shfrytëzim ekonomik te resurseve, ne atë mënyre qe te kontribuohet ne ekonominë e Kosovës, respektivisht te komunës duke iu përmbajtur ne përpikëri konventave Evropiane dhe specifikave tona qe kane te bëjnë me faunën dhe biodiversitetin.

Gjate përdorimit te resurseve natyrore, e këtu mendojmë ne llojet shtazore e posaçërisht ato qe trajtohen si kafshe për gjueti. Ekziston principi i përgjithshëm qe me përdorimin e tyre nuk guxon te rrënohet stabiliteti i tyre, te shkatërrohet mjedisi, e posaçërisht nuk guxon te vihet ne pyetje mbijetesia e tyre. Themelimi i vend-gjuetive te përbashkëta dhe menaxhimi i qëndrueshëm me gjueti dhe lloje te kafshëve te egra, nënkupton kultivimin, mbrojtjen e kafshëve dhe te mjedisit, si dhe krijimin e kushteve themelore te cilat duhet t'i mundësohen kafshëve (ushqimi, uji, qetësia, strehimi dhe hapësira për reproduktim). Përdorimi i tyre mund te behet vetëm ne kushtet popullacionit stabil, i cili ka reproduktim normal dhe atë ne vlerën e njëjtë ose me te vogël se shtimi real vjetor. Ne këtë mënyre mund te sigurohet përdorimi afatgjate i kafshëve te egra.

Qëllimi

Menaxhimi i vend-gjuetive te përbashkëta ne komunën e Deçanit është i rëndësishëm për arsye te ruajtjes se tërësisë se ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, kultivimit dhe mbrojtjen adekuate te kafshëve te egra, sidomos atyre te rralla dhe te rrezikuara, sigurimi i mirëqenies dine kushteve për shfrytëzimin ekonomike te resurseve, dhe nevoja për siguri, etike dhe standardet sipas konventave ndërkombëtare.

Qëllimi themelor i menaxhimit te vend-gjuetive te përbashkëta është:

- Ruajtja e mjedisit;
- Arritja e numrit optimal e te gjitha kafshëve për gjueti;
- Mbajtja e strukturës optimale te popullacionit sipas gjinisë dhe moshës ;
- Gjendja e mire shëndetësore e kafshëve për gjueti;
- Menaxhimi i qëndrueshëm;
- Relacioni optimal grabitqare/pre;
- Mbrojtja dhe ruajtja e llojeve te rralla dhe te rrezikuara;
- Arritja e objektivave te planifikuara ne menaxhimin e vend gjuetisë ne harmonizim me programin e menaxhimit.
- Mbajtja e kapaciteteve optimale

Te gjithë organizmat ne natyre janë ne varshmëri te ndërsjellët dhe se bashku përbejnë ekosistem te përberë. Ndikimi negativ i njeriut, vërehet ne relacionin jo te njëjte ndaj llojeve te ndryshme,

(ndihme dhe pengese) gjë qe rezulton me çrregullim te ekuilibrit natyror.

Ne ekosistemin integral, kjo baraspeshë është e vendosur dhe aktivitetet e njeriut duhet ti stimulojnë proceset natyrore.

Pozita dhe karakteristikat gjeografike

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaftë të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Gjendët pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore nga Deti Adriatik më gjatësi 90 km, kurse 220 km gjatësi nga Deti Egje.

Në perëndim kufizohet më Republikën e Shqipërisë që shtrihet prej PT-1660 deri PT-2366 në gjatësi prej 13850 m.

Në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi PT-2366 deri 2424 me gjatësi 9750 m.

Në veri kufizohet me Komunën e Pejës PT-2424 DERI 460 [Maznik] me gjatësi prej 50550m.

Në jug-lindje dhe jug kufizohet me Komunën e Gjakovës dhe Junikut nga PT-460 deri PT- 1660.

Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 284.4 km² ose 28.400 ha dhe përfshinë

- 8,940.4 ha tokë pjellore
- 14,420 ha pyje
- 5,079.6 ha kullosa.

Në këtë hapësirë jetojnë rreth 42,300 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011.

Lartësia mbidetare e territorit të Komunës së Deçanit varon prej 460m lartësi mbi detare në Maznikë, e deri në 2656m lartësi mbi detare në Gjeravicë që d.m.th. në sajë të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:

- në ultësirë që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit
- dhe në lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Parku Kombëtare)

Sipërfaqja e Parkut Kombëtarë nga sipërfaqja e përgjithshme e territorit , përfshinë :16,786.10 ha

Ndërsa sipërfaqja e tërësishme jashtë Parkut është 11,654.00 ha. Bazuar në këtë sipërfaqe e propozuar e vend gjuetisë se përbashkët, duke i hequr sipërfaqet e vendbanimeve, del te jete sipërfaqja e vend gjuetisë se përbashkët me strukturë toke bujqësore dhe pyje, prej:8,157.80 ha.

Në bazë të Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/ L-53 ,datë Nr. 02/ L-53 ,datë:16.02.2005 dhe Udhëzimeve Administrative;- MA-NR.10/2007 dhe UA Nr.06/2009, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvi përcaktohen kriteret e caktimit te zonave dhe procedurat për themelimin e Vend gjuetisë si:

- **Neni 2**, përcakton Zonat e gjuetisë: territori Zonës se gjuetisë në komunën e Deçanit përfshin sipërfaqen dominonte bujqësore ,rreth 6000 ha dhe pjesa tjetër me rreth 2150

ha me pyje te dushkut dhe zona kodrinore te gjveshura dhe shtrihen në lartësinë mbidetare ndërmjet 460 – 900 m/lmd.

- **Neni 8**, Përcaktimi i Vend gjuetisë e përbashkët.
- **Neni 10** – Akti i themelimit të vend gjuetisë, në bazë te këtij neni :

- Emërtimi i Vend gjuetisë se përbashkët do jetë: “Lojza”
- Përshkrimi i kufijve te Vend gjuetisë : nga **perëndimi** kufizohet me PK.

Në **jug-lindje** kufizohet me Komunën e Gjakovës(liqenin e Radoniqit) dhe në **jug** me Junikun,në **veri** kufizohet me Komunën e Pejës.


- Sipërfaqja e përgjithshme e vend gjuetisë llogaritet te jetë rreth 11.654,00 ha , ndërsa sipërfaqe aktive për gjueti llogaritet te jete 8.157,80 ha.
- Struktura e sipërfaqes së vend gjuetisë është si ne vijim: me rreth 6,000.00 tokë bujqësore me pjesën me te madhe misër dhe livadhe te kultivuara, diçka nga gruri dhe perime. Ndërsa rreth 2,000.00 ha janë pyje te ultë dhe djerrina.
- Llojet e kafshëve të egra te cilat gjinden në zonën e vend-gjuetisë.

Ne territorin e zonës se vend gjuetisë nga komisioni dalin te jen këto kafshë te egra:

-Kafshët e egra ne mbrojtje te posaçme janë: Macja e Egër 34 krerë, Ketri 137 krerë, Gjeraqina 55 copë, Skifteri 72 copë, Lundërza 24 krerë, Vjedulla 92 krerë dhe ujku 85 krerë.

Ndërsa kafshët e egra ne te cilat lejohet gjuetia sipas kalendarit te gjuetisë janë: Derri egër 125 krerë, Dhelpra 125 krerë, Lepuri 460 krerë, Pëllumbat e egër 930 copë, Patat e egra 127 copë, Thëllëza fushore 370 copë.

Harta e vend gjuetisë dhe kufijtë



Vend- gjuetia e përbashkët e propozuar me emërtimin “**Lojza**” shtrihet në sipërfaqen e komunës së Deçanit në kufijtë e saj administrativ duke mos llogaritur sipërfaqen e Parkut Kombëtar.

Kjo vend gjueti kufizohet me këta kufijtë natyral, saktësisht duke filluar nga Shkoza afër Junikut dhe vazhdon në **veri** mbi fshatrat: Voksh, Pobergj, Hulaj, Variq në lartësitë mbi detare deri në 700 m.

Vazhdon në **veri-perëndim** mbi Manastirin e Deçanit, kodra e Qafëzave dhe vazhdon deri te Gryka e Strellcit deri në Lybeniç përmes prrojit që lidhet me rrugën magjistrale Deçan-Peje dhe vazhdon përgjatë rrugës Raushiq-Baran deri te prroji i Gërvalles ,tutje në mes fshatrave Kryshëc dhe Dubovikë te vendi i quajtur varrezat dhe lisat e fshatit Rashiq, pastaj vazhdon në **jug-lindje** mbi fshatin Kotrodiq, vazhdon mes Lumëbardhit të Deçanit në fshatin Vranoc i Vogël dhe vazhdon në **jug-lindje** te fshatit Maznik.

Në **lindje** kufizohet me Kryq të Rakocit, Liçenin e Radoniqit, Sukan e Biteshit dhe del te Suka e Baballoqit dhe në drejtim të **perëndimit** deri në Shkozë.

Sipërfaqe kjo përafërsisht 8150h

Biodiversiteti

Ne artikullin 2 tii Konventës për Diversitetin Biologjik (Rio de Zhaneiro, Qershor 1992), biodiversiteti përkufizohet:

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike, në të cilat ato bëjnë pjesë, kjo përfshin diversitetin brenda llojit midis llojeve ekosistemeve”

Kosova ende nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit. Në mekanizmat e deritanishëm ligjor nuk është trajtuar mbrojtja e biodiversitetit, gjë e cila ka çuar në humbje të pakontrolluar sidomos të llojeve mjekësore të bimëve etj. Në mungesë të projekteve të mirëfillta, nuk është përpiluar asnjë Listë e Kuqe e as Libri i Kuq. Shkatërrimet e mëdha të pyjeve doemos janë reflektuar me humbjen të biodiversitetit.

Flora

Florën dhe faunën e Kosovës e bëjnë të rëndësishme dhe atraktive një numër i madh i llojeve endemike, relikte dhe subendemike. Bazuar në studimet e fundit që janë bërë në Kosovë, janë inventarizuar diku rreth 1800 lloje të florës, mirëpo supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në 2500 lloje. Në aspektin e shtrirjes vertikale të vegetacionit, pjesën më të madhe të masivit malor të Bjeshkëve të Nemuna në pjesën e poshtme e përfshin vegetacioni gjethërenës, në atë të epërme atë halor, ndërsa mbi kufirin e epërm pyjor gjendet vegetacioni i kullotave dhe livadheve të alpin. Në pyjet gjethërenësedominojnë ato të dushkut dhe ahut, ndërsa në ato halore të bredhit, hermoqit, rrobullit dhe arnenit.

Fauna

Në Kosovë janë të përhapura rreth 230 lloje të egra të kurrizoreve, kurse pa kurrizore janë shumë pak të hulumtuar dhe nga ky grup ekzistojnë të dhëna për afro 150 lloje të fluturave dhe për afro 400 taksona temakro bentosit të ujerave.

Bjeshkët e Nemuna dhe Kosova në përgjithësi, nga aspekti faunistik i përkasin rajonit Hollarktik përkatësisht në rajonin Euro-Siberian.

Në Bjeshkët e Nemuna gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve që janë mjaft të rralla për rajonin

e Ballkanit dhe më gjere, prej tyre ka relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe përket të arsye gjenden në listat dhe në librat e kuq ndërkombëtar.

Llojet me reprezentative te faunës se Bjeshkëve te Nemuna, siç janë: rrëqebulli (Lynx lynx), ariu i murrme (Ursus arctos), kaprolli (Capreolus capreoltis), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), shqiponja perandorake (Aquila heliaca), shqiponja e maleve (Aquilachrysaetos), fajkoi thonj bardhe (Falco naum mani), pulegra (Tetrao urogallus) etj, kane status kombëtar dhe ndërkombëtar te mbrojtur. Ato gjenden ne listën e IUCN (Unioni botëror për ruajtjen e natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Evropiane), WR-RL (Lista e kuqe botërore), LKSH (Libri i kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për Gjuetinë) etj.

Kriteret për themelimin dhe menaxhimin e vende gjuetisë te përbashkët në komunën e Deçanit

Dokumenti -projekti për themelimin e vend-gjuetive te përbashkëta është hartuar duke u bazuar ne kriteret e Ligjit për Gjuetinë dhe Udhëzimet Administrative te data nga ky ligj,pra duke u bazuar ne:

- llojin dhe numrin e kafshëve te egra te cilat natyrshëm jetojnë apo kryesisht kultivohen ne një sipërfaqe te caktuar te tokës;

- destinimin e vend gjuetisë;

- pronësia e tokës,

- llojin e zonës ne te cilën themelohet vend gjuetia - largësisë mbidetare, kufijtë natyror të territorit ku themelohet vend gjuetia etj. Vendgjuetia e Përbashkët **"Lojza"**-Deçan

(emërtimi, sipërfaqja, **kufijtë** natyror dhe llojet e kafshëve te egra)

Emërtimi:

Vendgjuetia e propozuar për menaxhim është vend gjueti e përbashkët,ku për qellim kryesor ka rritjen, mbrojtjen dhe kultivimin e llojeve te caktuara te kafshëve te egra, dhe është emërtuar Vend gjuetia e Përbashkët **"Lojza"** ne Deçan.

Sipërfaqja

Sipërfaqja aktive e vend gjuetisë është 8.157,80 ha ,ku ne tere ketës përfaqe mund te zhvillohen aktivitete gjuetie, dërsa vende te ndaluara për gjueti te parapara me nenin24 te Ligjit për Gjuetine,Nr.02/L-53 jan 3.469,20 ha.

Llojet e kafshëve te egra

Llojet e kafshëve te egra te pranishme dhe dominuese ne ketë vend-gjueti janë:

Dhelpra.....125-140krerë;

Derriegër125-145krerë;

Lepuri.....460-485krerë;

Thëllëza e t fushës.370-382krerë;

Plumba te egër.....930-950 cope

Pata te egra.....127-135 cope

Kafshët e egra ne mbrojtje te posaçëm janë :

Macja e egër.....34-40 krerë

Ketri.....137-150 krerë

Gjeraqina.....55-60 cope

Skifteri.....72-80 cope

Lundërza.....24-30 krerë

Vjedulla.....92-100 krerë

Ujku.....85- 90 krere

Akti i menaxhimit te vend gjuetisë se përbashkët

"LOJZA"ne Deçan

emërtimi i vend gjuetisë.

përshkrimi i kufijve te vend gjuetisë;

sipërfaqja e tërësishme e vend gjuetisë ne hektar (ha);

struktura e sipërfaqes (pyje dhe toka pyjore, livadhe, kullota, ara, kopshte, etj);

llojet e kafshëve te egra te pranishme dhe

dominuese; kafshët e egra te cilat janë nen mbrojtje

te posaçme;

çmimi fillestar;

te dhënat tjera te nevojshme te cilat kërkohen me rastin e parashtrimit te

kërkesës, harta e vend gjuetisë dhe kufijtë e vizatuar te saj.

Drejtori i DBPZHR
Rifat Stojkaj

